Kenney, G. M., Cook, A., & Pelletier, J. (2009). *Prospects for reducing uninsured rates among children: How much can premium assistance programs help?* Retrieved from Urban Institute website: <http://www.urban.org/url.cfm?ID=411823>



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/921

Datë: 24/10/2019

Në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 87, pikës 2 dhe 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe me propozim të Komisionit të Studimeve të Universitetit të Prishtinës, Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me 10.06.2019 miraton

**RREGULLORE**  
**PËR STUDIMET THEMELORE - BACHELOR**

**Dispozitat e përgjithshme**

**Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret unike për organizimin dhe llojet e studimeve, kushtet e regjistrimit në studime, kushtet e regjistrimit të vitit, kohëzgjatja e studimeve, ndërrimi i programit të studimeve, punimi i diplomës së bachelorit, procedura e mbrojtjes si dhe çështjet tjera të rëndësishme për studimet bachelor në Universitetin e Prishtinës në tekstin e mëtejshëm UP në Prishtinë.

**Organizimi dhe llojet e studimeve**

**Neni 2**

Studimet bachelor organizohen në kuadër të Universitetit të Prishtinës. Ato mund të organizohen edhe në bashkëpunim me Universitetet tjera në bazë të kontratave për partneritet.

**Neni 3**

Studimet bachelor organizohen sipas plan - programit mësimor të akredituar.

**Neni 4**

1. Studentët njoftohen me kohë përmes web faqes me: strukturën e programit studimor, orarin e mësimit dhe provimeve, të cilat do të shpallen në fillim të vitit akademik në përputhje me Statutin e UP-së.
2. Orari i mësimit dhe provimeve nuk mund të ndryshohet pa aprovimin paraprak të Prodekanit për mësim.

### **Neni 5**

1. Mësimdhënësit janë të obliguar që në fillim të vitit të ri akademikë ti njoftojnë studentët me syllabuset e lëndëve si dhe t'ju sigurojnë së paku dy termine me kohëzgjatje një orëshe për konsultime.
2. Syllabuset dhe materialin mësimor mësimdhënësi i lëndes është i obliguar ti publikoj ne SEMS.
3. Terminet e konsultimeve duhet të jenë të shpallura në derën e kabinetit të mësimdhënësit dhe ne web - faqen zyrtare te fakulteteve.

### **Kushtet e aplikimit dhe regjistrimit në studime**

#### **Neni 6**

1. Në studimet themelore-bachelor kanë të drejtë te aplikojnë të gjithë ata të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm dhe kanë përfunduar provimin e maturës, nëse ka pasur provim te maturës.
2. Numrin e studentëve të rinj për program studimor, kriteret e pranimit përkatësisht regjistrimit, dinamikën e rrjedhës së procesit, provimin pranues, shpalljen e rezultatit preliminar, ankesat dhe shpalljen e rezultatit final në mënyrë të hollësishme i përcakton konkursi publik i shpallur nga ana e Senatit të UP-së.

#### **Neni 7**

1. Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të pranimit të studentëve të rinj, Këshilli i njesive akademike mund të emëroj disa komisione. Me këtë rast, asnjëri anëtar nuk mund të jetë i emëruar njëkohësisht në dy komisione.
2. Përgjegjësitë dhe obligimet më të hollësishme të komisioneve i përcakton Këshilli i njesive akademike.

#### **Neni 8**

1. Përzgjedhja, përkatësisht përpilimi i listës preliminare bëhet në bazë të konkursit dhe bëhen publike në web faqe të njesive akademike.
2. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të paraqesin ankesë pas publikimit të listave preliminare.
3. Pas shqyrtimit të ankesave nga komisioni i ankesave, rezultatet përfundimtare bëhen publike në web faqe të njesive akademike.

### **Kushtet e regjistrimit të vitit**

#### **Neni 9**

1. Senati i Universitetit të Prishtinës me vendim të veçantë përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studentëve.
2. Pagesat për studimet bachelor në UP, do të bëhen në bazë të udhëzimeve administrative të MASHT-it dhe vendimeve të Këshillit Drejtues të UP-së.

### **Neni 10**

1. Vitin e ri akademik studenti e fillon duke u regjistruar në semestrin dimëror.
2. Studenti mund ta regjistroj semestrin veror, vetëm pasi ta ketë vërtetuar paraprakisht atë dimëror.
3. Përzgjedhjen e lendeve zgjedhore te programit studimor, studentet kane mundësi ta bëjnë me se largu deri me 30 shtator.
4. Studenti nuk mund t'i nënshtrohet provimeve në afatin e janarit, pa e regjistruar semestrin dimëror, kurse në afatin e qershorit pa e regjistruar semestrin veror.
5. Studenti nuk mund t'i nënshtrohet provimeve të vitit aktual të studimeve para se t'i përfundoj ato të vitit paraprak.
6. Ndaj studentit i cili i nënshtrohet provimeve të vitit aktual pa i përfunduar ato të vitit paraprak, do të merren masa në përputhje me rregulloren për procedurë disiplinore.
7. Studenti i cili nuk i plotëson kushtet për regjistrim në vitin vijues akademik, është i obliguar që të përsërisë regjistrimin e vitit të njëjtë të studimeve.
8. Afati i regjistrimit të semestrit përcaktohet me programin studimor, përkatësisht me vendim të Senatit të UP-se.

### **Neni 11**

1. Vijimi i rregullt i procesit mësimor dhe kryerja e obligimeve të tjera të parapara me programin e studimeve në lëndën e caktuar konfirmohet në fund të semestrit në sistemin elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS).
2. Konfirmimi mbi kryerjen e obligimeve merret, nëse ndryshe nuk është përcaktuar me programin e studimeve, kur vërtetohet se studenti ka qenë i pranishëm së paku 75% të orëve të ligjëratave dhe të ushtrimeve numerike.
3. Në rastin e ushtrimeve laboratorike nevojitet kryerja e plotë e obligimeve të studentit.
4. Në qoftë se studenti ka munguar nga ushtrimet laboratorike me leje paraprake nga prodekani për mësim, bazuar në kërkesën e arsyetuar dhe të protokolluar, atij i lejohet edhe një afat kohorë për kompensimin e ushtrimeve laboratorike.
5. Afatet shtesë për kompensimin e ushtrimeve laboratorike zakonisht lejohen pas përfundimit të ciklit të plotë të ushtrimeve laboratorike, e më së voni 7 ditë nga përfundimi i semestrit.

### **Neni 12**

Studenti e regjistron semestrin nëse i ka kryer të gjitha obligimet e semestrit paraprak të parapara me plan program të studimeve dhe që vërtetohet nga mësuesit e lëndëve përkatëse dhe programi SEMS.

### **Mobiliteti, vazhdimi i studimeve, ndërrimi i drejtimit dhe njohja e provimeve**

#### **Neni 13**

1. Mobiliteti i studentëve dhe ndërrimi i programit studimor është përcaktuar me Statutin e UP-së, nenet, 142, 143 dhe 155

#### **Neni 14**

Kërkesa për ndërrimin e programit, vazhdimin e studimeve dhe njohjen e provimeve duhet të bëhet para fillimit të vitit akademik. Për dokumentacionin që duhet t'i bashkëngjitet kërkesës dhe dinamikën e procedurës - kohën e parashtrimit, mënyrën e parashtrimit si dhe afatin e përmbylljes së kërkesës studentët do të njoftohen me kohë në web faqe të njësive akademike.

#### **Neni 15**

1. Nëse studenti nuk arrin të përfundoj studimet me programin studimor në të cilin është regjistruar (sipas afatit të përcaktuar në Statut), mund të vazhdon studimet me automatizëm në programin e njëjtë të ri akredituar.
2. Në rast se programi ka pësuar ndonjë ndryshim gjatë ri akreditimit, atëherë ai duhet të nënshtrohet vetëm atyre provimeve të cilat nuk kanë qenë pjesë e programit paraprak.
3. Në rast se programi pëson ndryshime të mëdha ose është mbyllur atëherë procedohet sipas nenit 14 pikal.

#### **Neni 16**

1. Këshilli i njësive akademike merr vendim pas propozimit të Komisionit të Studimeve lidhur me kërkesën e studentëve për ndërrim programi, vazhdim të studimeve dhe njohje të provimeve pas pranimit të propozimit nga komisioni i studimeve të departamentit përkatës dhe aprovimit të atij propozimi nga komisioni i studimeve të njësive akademike.
2. Kërkesa e protokolluar e studentit për ndërrim programi, vazhdim të studimeve dhe njohje të provimeve shqyrtohet nga një komision tre anëtarësh nga departamenti ose njësia akademike.
3. Në rastet kur nuk funksionon departamenti ose numri i stafit akademikë në departamenti është më i vogël se katër, atëherë formimi i komisionit bëhet në bashkëpunim me prodekanin për mësim dhe shefin e departamentit ose programit studimor.
4. Në bazë të raportit të përgatitur nga ky komision, komisioni i studimeve i njësive akademike i propozon këshillit të saj vendimmarrjen. Vendimin përfundimtar e merr këshilli i njësive akademike.

### **Neni 17**

1. Në rast se studenti pasi të mbaron studimet në një program studimor, aplikon dhe regjistrohet në programin e ri studimor, atëherë në bazë të nenit 142 pika 5 nuk mund të konsiderohet ndërrim programi.
2. Studenti me këtë rast obligohet që të ndjek ligjërata dhe të futet në provime njëjtë sikurse studentët e tjerë.
3. Kërkesa për pranimin e provimeve nga programi i vjetër në të riun bëhet pas secilit semestër të regjistruar.
4. Vendimi për njohje të notës bëhet në bazë të Nenit 16, me këtë rast duke u konsultuar edhe mësimdhënësi i lëndës nga ana e komisionit të studimeve.

### **Neni 18**

1. Ç' regjistrimi i studentit apo tërheqja e dëftesave dhe diplomës origjinale mund të behet pas aprovimit të kërkesës nga sekretari i fakultetit.
2. Ç' regjistrimi mund të behet nga studentit personalisht apo personi tjetër me autorizim të noterizuar të studentit.
3. Dëftesa dhe diploma origjinale mund të tërhiqen më së shumti deri në 5 ditë pune, në rast të mos kthimit të dokumentacionit sipas afatit të paraparë studentit ç' regjistrohet.
4. Me rastin e ç' regjistrimit studentit dorëzon indeksin apo ID-kartelën e cila bëhet e pavlefshme me rastin e ç' regjistrimit, ndërsa me rastin e tërheqjes së dokumentacionit për një afat të caktuar studentit dorëzon indeksin apo ID-kartelën deri në kthimin e dokumentacionit.

## **Vlerësimi dhe përcaktimi i suksesit akademik**

### **Neni 19**

Përcaktimi i suksesit akademik dhe vlerësimi bëhet sipas Statutit të UP-së nenet 108 dhe 109.

### **Neni 20**

Format, mënyrat, dinamikat dhe vlerësimet e provimeve bëhen sipas neneve 110,112 dhe 113 të Statutit të UP-së.

### **Neni 21**

Në rast se studentit nuk është i kënaqur me rezultatin e provimit, ai në bazë të nenit 114 të Statutit të UP-së parashtron ankesë. Për kohën, mënyrën e parashtrimit dhe trajtimit të ankesës aplikohet nenin 114 të Statutit të UP-së.

### **Neni 22**

Të drejtën e riprovimit studentit e realizon në bazë të nenit 115 të Statutit të UP-së.

## **Kohëzgjatja e studimeve**

### **Neni 23**

1. Studimet themelore - bachelor zgjasin 3 dhe 4 vite dhe kërkojnë arritjen e 180/240 ECTS, përveç nëse me programe të veçanta është përcaktuar ndryshe.
2. Provimet në studimet bachelor mbahen gjatë afateve të rregullta të provimeve.

### **Neni 24**

1. Programet e studimeve bachelor përfundojnë me punimin e diplomës për bachelor ose me provim para komisionit në pajtim me programet e tyre të studimeve, përveç fakulteteve të cilat e kanë në një mënyrë tjetër të rregulluar këtë çështje.
2. Punimi i diplomës për bachelor punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për bachelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Aplikimi për elaborimin e diplomës së bachelorit me dy ose tre studentë (grupi kërkimor) vendoset nga këshilli i njësive akademike përkatës, ndërsa aprovohet në mbledhjen e radhës së këshillit të fakultetit.

## **Punimi i diplomës së bachelorit**

### **Neni 25**

1. Studenti ka të drejtën ta paraqes kërkesën për nisjen e procedurave për punim e diplomës së bachelorit, pasi të ketë përfunduar 50% të ECTS kredive për provimet e vitit të fundit.
2. Pasi të konsultohet me profesorin për punim diplomës së bachelorit, studenti merr kërkesën me numër protokollit në arkivin e njësive akademike, dhe i dorëzon shefit, sekretarit të departamentit/njësive akademike ose bartësit të programit (formulari F1B)
3. Në mbledhjen e departamentit aprovohet kërkesa për temë, caktohet mentori dhe komisioni për mbrojtje.
4. Për rastet kur nuk funksionojnë departamentet ose numri i stafit akademikë në departament është më i vogël se katër, si dhe rastet e implementimit të programit studimor multidisiplinar, atëherë, pika 3 trajtohet nga prodekani për mësim i njësive akademike.
5. Mentor mund të jetë mësimdhënësi nga personeli akademik i cili të paktën është Dr.sc. në UP ose ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve.
6. Anëtar i komisionit për mbrojtjen e diplomës së bachelorit mund të jetë nga personeli akademik i UP-së dhe jashtë saj (staf akademik nga universitetet tjera të akredituara dhe në

përputhje me fushën e studimeve), ku së paku njëri prej anëtarëve duhet të ketë njërën nga thirrjet për Profesor. Për anëtarë të jashtëm vendos Këshilli i fakultetit, me propozim të departamentit.

7. Prej datës kur aprovohet kërkesa për punim diplomës së bachelorit dhe caktohet mentori, deri në datën e mbrojtjes publike, duhet të kalojnë së paku tre muaj.

#### **Neni 26**

1. Punimi i diplomës së bachelorit duhet të jetë i shkruar qartë, në pajtim me normat e shkrimit akademike, me një terminologji të përpunuar dhe me redaktuar e teknike të nevojshme dhe sipas udhëzuesit të UP-se.
2. Punimin e diplomës së bachelorit, studenti e dorëzon në një kopje fizike të protokolluar dhe në formë elektronike (CD) së paku 7 ditë para mbrojtjes.
3. Nëse punimi i diplomës së bachelorit i kandidatit është vlerësuar pozitivisht, plotësohet raportin për aprovimin e punimit të diplomës së bachelorit. Raporti merret në shërbim të studentëve apo shkarkohet nga ueb faqja e njësive akademike (formulari F2B)
4. Kërkesa dhe raportin i temës deri në përmbyllje qëndrojnë të mentori i temës.

#### **Neni 27**

1. Mbrojtja e punimit të diplomës së bachelorit është publike dhe zhvillohet para komisionit të përbërë nga tre anëtarë, të propozuar nga departamenti.
2. Komisioni plotëson raportin për mbrojtjen e punimit të diplomës së bachelorit i cili është pjesë e raportit për pranim të temës.
3. Notën e arritur në mbrojtje, komisioni e shënon në raport, në fletëparaqitje fizike dhe SEMS.
4. Mentori, kërkesën e temës, raportin e nënshkruar dhe protokolluar së bashku me fletëparaqitjen fizike e dorëzon në shërbimin e studentëve dhe duhet të jenë pjesë të domosdoshme e dosjes fizike të kandidatit.
5. Nëse kandidati nuk e ka mbrojtur me sukses punimin e diplomës së bachelorit, atëherë mund të riorganizohet mbrojtja brenda 3 muajsh. Këtë ka të drejtë mund ta ushtroj vetëm një herë.

#### **Neni 28**

1. Studenti i diplomuar në njësive akademike të UP-se, merr titullin “Bachelor i shkencës” ose “Bachelor i arteve, sipas programit të akredituar.
2. Deri në ditën e marrjes së diplomës studentit i lëshohet çertifikata e diplomimit e nënshkruar nga Dekani i Fakultetit.

#### **Neni 29**

1. Suksesi i përgjithshëm i studentit në fund të studimeve përcaktohet me notën mesatare e cila paraqet mesataren përfundimtare të notave kaluese nga të gjitha provimet duke përfshirë edhe provimin e temës së diplomës.
2. Universiteti, me vendim të veçantë, parasheh çfarë duhet të përmbajë dosja e studentit të diplomuar para se t'i lëshohen certifikata e diplomimit dhe diploma.

### **Përgjegjësia disiplinore**

#### **Neni 30**

1. Procedurat e marrjes së studentëve në përgjegjësi disiplinore përcaktohen me rregullore të veçantë.
2. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjohen nga Komisioni disiplinor i cili i propozon Këshillit të Fakultetit masën disiplinore sipas veprës së kryer.
3. Këshilli i Fakultetit mund t'i përjashtoj nga Fakulteti përkohësisht ose përgjithmonë studentët që i shkelin rëndë rregullat.
4. Studentët kanë të drejtë të ankohen në komisionin për ankesa në njësi akademike, ndaj masës disiplinore.

#### **Neni 31**

Të gjitha veprimet dhe procedurat nga domeni i kësaj rregullore të filluara me akte paraprake duhet të përfundojnë më së largu 3 muaj pas aprovimit të kësaj rregullore.

### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

#### **Neni 32**

1. Kjo rregullore me propozimin e Komisionit të Studimeve miratohet nga Senati i Universitetit të Prishtinës.
2. Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Ligjit Mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga data 1.10.2019.
4. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen me procedurën e njëjtë me të cilën është miratuar.



Senati i UP-së

Prof. Dr. Marjan Dema, kryesues



Nr. Prot.: \_\_\_\_\_

Date: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

## KË R K E S Ë

Për: Departamentin e \_\_\_\_\_

Nga: \_\_\_\_\_ student/e i/e

departamentit \_\_\_\_\_, programi studimor \_\_\_\_\_

**Lënda: Kërkesë për lejimin e punimit të diplomës bachelor dhe caktimin e mentorit**

Në bazë të Rregullores për studime bachelor të UP-së, kërkoj nga departamenti i sipërshtuar të më lejoj punimin e diplomës bachelor, me titull: \_\_\_\_\_

Mentori: \_\_\_\_\_

Kërkesës i'a bashkëngjisë:

1. Certifikatën e notave<sup>1</sup>;
2. Vërtetimin për statusin e studentit;
3. CV.

Më datë: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_, Prishtinë

Nënshkrimi i studentit

Tel: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

<sup>1</sup> (Certifikata duhet të vërtetoj se studenti ka akumuluar të paktën 50% të ETCS në vitin e fundit të studimeve)



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

**RAPORTI PËR APROVIMIN, FORMIMIN E KOMISIONIT DHE MBROJTJEN E  
PUNIMIT TË DIPLOMËS SË BACHELORIT**

Në bazë të kërkesës së studentit \_\_\_\_\_

të datës \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, numër protokollit: \_\_\_\_\_,

departamenti i \_\_\_\_\_ në mbledhje e mbajtur me datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

aprovon kërkesën për lejimin e punimit të diplomës bachelor me

titull: \_\_\_\_\_

Mentori: \_\_\_\_\_

Prishtinë, \_\_\_\_\_ Shefi i departamentit: \_\_\_\_\_

Në mbledhjen e datës \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, departamenti i \_\_\_\_\_, propozon komisionin e mbrojtjes me këtë përbërje:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

Prishtinë, \_\_\_\_\_ Shefi i departamentit \_\_\_\_\_

**RAPORTI I MBROJTJES PËR PUNIMIN E DIPLOMËS SË BACHELORIT**

Me datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, u organizua mbrojtja e punimit të diplomës së bachelorit.

Vlerësimi përfundimtar: \_\_\_\_\_

Nënshkrimet e komisionit:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

Më datë: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_ Prishtinë



**Universiteti i Prishtinës  
“Hasan Prishtina”**

**UDHËZUES PËR TEMËN E DIPLOMËS BACHELLOR**

**Për studentët e programeve Bachelor ne Universitetin e Prishtines**


Prishtinë, 2019

## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| HYRJE.....  | 3  |
| PUNIMI I DIPLOMËS: STANDARDET DHE PROCESI.....                    | 4  |
| VLERËSIMI DHE PËRSHKRIMI I NOTAVE.....                            | 6  |
| ETIKA HULUTUESE DHE PLAGJIARIZMI.....                             | 8  |
| MODELI I PUNIMIT TË DIPLOMËS.....                                 | 9  |
| SHTOJCAT.....   | 31 |
| 1. Model i panifikimit të një ore mësimore për nivelin fillor     |    |
| 2. Modeli i planifikimit të një aktiviteti për klasat përgatitore |    |
| 3. Kërkesa për lejimin e temës                                    |    |

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

PROGRAMI: VENDOSËT PROGRAMI I STUDIMEVE



**PUNIM DIPLOME**

**[TITULLI I PUNIMIT]**

Mentori/ja:

Prof. Dr.(Asoc.;Ass) Emri dhe mbiemri

Kandidati/ja:


Emri i kandidatit /es

*Prishtinë, muaji VITI*

Qëllimisht e lënë e bardhë

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

PROGRAMI: VENDOSËT PROGRAMI I STUDIMEVE



**PUNIM DIPLOME**  
**[TITULLI I PUNIMIT]**

Mentori/ja:

Prof. Dr.(Asoc.;Ass) Emri dhe mbiemri

Kandidati/ja:

Emri i kandidatit /es

*Prishtinë, muaji VITI*

Qëllimisht e lënë e bardhë

Deklarata etike

# PËRMBAJTJA

|  |       |
|--|-------|
| Abstrakti.....                               | ..... |
| Hyrje .....                                  | ..... |
| Shqyrtim i literaturës.....                  | ..... |
| Qëllimi i hulumtimit .....                   | ..... |
| Metodologjia.....                            | ..... |
| Rezultatet .....                             | ..... |
| Diskutimet.....                              | ..... |
| Konkludimet .....                            | ..... |
| Rezyme (ne te dy gjuhët).....                | ..... |
| Literatura /Referencat .....                 | ..... |
| SHTOJCA A: Titulli i shtojcës/shtojcave..... | ..... |

DRAFT

Hapsirë e thjeshtë  
mes rreshtas 1.0

## ABSTRAKTI

Hapsirë mes  
rreshtash në tërë  
tekstin 1,5

Në parim, abstrakti nuk duhet t'i tejkalojë **350** fjalë. Abstrakti së bashku me fjalët kyçe assësi nuk duhet të jetë më i gjatë dhe më i shtrirë se një faqe.

Tema tashme e studiuar paraqitet përmes një abstrakti: me linjen teorike e cila e mbështet punimin.

Qëllimin e problemit të studiuar dhe rëndësinë e këtij studimi.

Po ashtu duhet të përmendet metodologjia e vënë në praktikë (sasiore, cilësore), detaje rreth mostrës, si dhe rezultatet e dala nga studimi dhe një sqarim i shkurtër e konkluzioneve të arritura.

Fjalet kyçeterme që përfqësojnë punimin, duhet vënë ndërmjet tri deri pese fjalë kyçe.

P.sh., arsimim, metodë, planifikim, koncepte, matematikore

## HYRJE

Në hyrje bëhet një paraqitje e hollësishme e rëndësisë së problemit, që paraqet thelbin e hulumtimit dhe shpjegohen arsyet, që e kanë nxitur kandidatin/en për zgjedhjen e temës dhe të problemit të caktuar.

Në hyrje studenti duhet, përveç motiveve dhe rëndësisë që përmend për hulumtimin apo studimin në pyetje, të përshkruaj shkurtimisht përmbajtjen e temës në pika të shkurtëra në mënyrë që lexuesi të motivohet ta lexojë punimin në tërësi.

## SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në këtë pjesë kandidati bën një përshkrim të përgjithshëm të “fushës së studimit” dhe e vendos temën e studiuar në kuadër të saj. Këtu është e domosdoshme të paraqiten, krahasohen dhe vlerësohen teoritë më të rëndësishme, që lidhen me temën e propozuar. Rekomandohet të bëhet një përshkrim i përgjithshëm dhe i shtjelluar hollësisht i hulumtimeve përkatëse (libra, artikuj, raporte hulumtuese), që janë bërë prej autorëve të tjerë (vëndorë dhe ndërkombëtarë), me përqendrim në gjetjet dhe përfundimet e tyre. Hulumtimet e kohëve të fundit (p.sh. të botuara gjatë këtij dhjetëvjeçari) duhet të vendosen në radhë të parë. Kandidati/ja duhet ta bëjë të qartë se çfarë dihet në fushën

përkatëse (në lidhje me temën apo problemin që ka shtjelluar) dhe se çka nuk është trajtuar ende në mënyrë sistematike, apo cilat pyetje kanë mbetur pa përgjigje.

Një prej kërkesave kryesore të kësaj pjese është një *përshkrim i perspektivës teorike*. Në punën kërkimore gjithnjë fillohet prej të kuptuarit teorik, që e mbizotëron fushën e caktuar. Paradigmat dhe konceptet teorike të autorëve/shkencëtarëve të njohur, jo vetëm që ndikojnë në hulumtimin (e ardhshëm), por ato shërbejnë si fillesa të një studimi në lidhje me një ‘fushë’ të caktuar.

Si rrjedhojë, kandidati/ja duhet të vendosë se cilën “rrymë teorike” e mbështet apo përcjell punimi, përmes paradigmatve dhe koncepteve teorike, që janë të përafërta me problemin, që e ka parashtruar dhe që e mbështetin më së miri hulumtimin e tij/saj. Për të qenë më konkret: ky kapitull duhet të përfshijë një analizë të literaturës së përzgjedhur, për shembull, një paraqitje të ngjeshur të teorive/autorëve kryesorë dhe të monografive më të rëndësishme shkencore në lëmin e caktuar. Po ashtu, duhet të bëhet e qartë se pse këto teori janë të rëndësishme dhe të dobishme për hulumtimin e planifikuar.

Udhëzimet APA për CITIMIN në TEKST dhe se si duhen referuar, mund t'i shohim në vijim, pra, citimet mund të jenë parafrazime ose citim i drejtpërdrejt i një burimi nga puna e ndonjë autori tjetër. Citimet zakonisht bëhen me emërtimet e autorëve, më mirë të themi, Mbiemri i autorit dhe viti i publikimit dhe vetëm kur citohet literalisht dhe drejtpërdrejt, atëherë vihet numri i faqes/faqeve. Shembujt e mëposhtëm të huazuar nga botimi i gjashtë i APA (APA, 2010). [*Shih referencat bibliografike*].

Citimi indirekt përmes citimit me kllapa, historikisht libraritë vlerësojnë lart lirinë intelektuale dhe sjelljen e konfidencialitetit (LaRue, 2007).

Mirëpo, nëse citimi indirekt bëhet me autorin si pjesë të tregimit, atëherë mund të themi LaRue (2007) identifikoi lirinë intelektuale dhe sjelljen e konfidencialitetit si dy vlera kyçe, të cilat janë mbajtur historikisht nga libraritë.

Citim i drejtpërdrejtë me kllapa: Darëin-i përdori metaforën e lisit jetësor “për të shprehur një formë tjetër të ndërlidhshmërisë gjenealogjike e jo ekologjike” (Gould & Brown, 1991, f. 14).

Citim i drejtpërdrejtë me autorin si pjesë e tregimit: Gould dhe Brown (1991) shpjeguan se Darëin-i përdori metaforën e lisit jetësor “për të shprehur një formë tjetër të ndërlidhshmërisë gjenealogjike e jo ekologjike” (f. 14).

Brenda tekstit mund edhe të citojmë burime dytësore. Janë ato burime, të cilat ne i citojmë nga një punim tjetër tërthorazi, të cilin e lexojmë dhe hasim në një citim që mund të na interesojë. Pra, në këto raste duhet të përmenden të dyja burimet edhe i pari edhe dytësori. Në shembullin në vijim, studimi i Seidenberg dhe McClelland është përmendur në artikullin e Coltheart, Curtis, Atkins, & Haller. Pra citohet si: studimi i Seidenberg dhe McClelland-it (siç citohet në Coltheart, Curtis, Atkins, & Haller, 1993) i paraqiti botës një vizion të shkurtër të procesimit të fjalëve. Pastaj në fund, në faqen e referencave bibliografike, duhet të citohet burimi dytësor, i cili është lexuar nga ju, e jo ai studimi origjinal, shih shembullin në vijim.

Coltheart, M., Curtis, B., Atkins, P., & Haller, M. (1993). Models of reading aloud: Dual-route and parallel-distributed processing approaches. *Psychological Review*, 100, 589-608.

## QËLLIMI I HULUMTIMIT

Kah fundi i HYRJES, duke pasur kornizën e qartë teorike mbi të cilët ndërtohet studimi, duhet të flasim për qëllimin konkret të studimit.

*Qëllimi i hulumtimit* duhet të përkufizohet qartë, saktë dhe mirë. *Qëllimet e hulumtimit* duhet të jenë të harmonizuara me problemin apo çështjen, që është studiuar. Parashtrimi i problemit dhe relevanca e tij duhet të jetë e lidhur në kuptim me perspektivën teorike, por edhe me pyetjen e hulumtimit, hipotezat dhe metodat e parashikuara të kërkimit.

Lidhur me qëllimin apo qëllimet e punimit, duhet të specifikohen qartë pyetjet e hulumtimit/ apo hipotezat e tij.


## METODOLOGJIA

Shumica e temave të diplomave në studimet themelore mbështeten më pak në metodologjitë kërkimore sfiduese. Në këtë rast, pyetjet më të shpeshta janë, p.sh. “sa prej asaj?” dhe me “çfarë cilësie?” Para së gjithash kandidati duhet ta përkufizojë *llojin e qasjes hulumtuese për problemin e zgjedhur*.

## REZULTATET DHE DISKUTIMET

Në këtë seksion, duhet të shpjegohet mënyra dhe/apo programi, që është përdorur për analizë të të dhënave. Nëse të dhënat janë sasiore (kuantitative), mund të bëhen analiza të ndryshme, si për shembull, analiza e të dhënave u realizua përmes programit Exel ose programeve tjera statistikore, përmes një analize të krahasimit të mesatareve të pikëve në testet e matematikës të djemve dhe vajzave

Vriabla e varur në këtë rast janë pikët e testeve të matematikës ndërsa variabla e pavarur është gjinia. Këto analiza duhet të paraqiten me grafikë ose tabela. (shih shembullin më poshtë)



Grafiku 1.

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas nivelit shkollor dhe gjinisë.

| Nivel shkollor          | Gjinia   |          |             |
|-------------------------|----------|----------|-------------|
|                         | Gjithsej | Femërore | Mashkullore |
| Klasa e 1 <sup>te</sup> | 22       | 8        | 14          |
| Klasa e 2 <sup>te</sup> | 22       | 8        | 14          |
| Klasa e 5 <sup>te</sup> | 23       | 11       | 12          |
|                         | 67       | 27       | 40          |

Një çështje shumë më rëndësi, brenda seksionit të analizës së të dhënave dhe të rezultateve, është qartësimi i faktit, se nuk është e nevojshme të paraqiten të gjitha rezultatet nga të dhënat në tabela dhe figura, e madje shpesh hasim në të dyja versionet për të dhënat e njëjta.

Studenti duhet të jetë në gjendje të nxjerrë nga të dhënat e tij, vetëm rezultatet më përfaqësuese të studimit dhe t'i bëjë të dukshme për lexuesin në formën që konsideron më të mirë, tabelë apo figurë dhe pastaj të shpjegojë se çfarë përfaqësojnë ato të dhëna/rezultate shumë shkurtimisht. Sipas nevojës, rezultatet më të detajuara mund të vendosen në shtojcat përkatëse. Është me rëndësi që, gjatë paraqitjes së rezultateve, të kthehemi tek qëllimi dhe tek pyetjet kërkimore për të bërë lidhjen logjike me to.

## KONKLUKDIMET

Krejt në fund, procedohet me disa paragrafë, të cilët janë konkluzioni përfundimtar i punimit dhe nëse ka kufizime studimi, të përmenden. Është me rëndësi të ikim nga dhënia e një liste rekomandimesh për grupe të synuara, por të elaborohet në mënyrë narrative konkludimi që është arritur në lidhje me qëllimin dhe pyetjet kërkimore dhe hipotezat që janë ngritur në fillim të studimit. Këtu do të duhej të lexohej qartë kontributi shkencor i studimit.

Për konkludimet ose përfundimet e nxjerra, mund të jepen rekomandime përkatëse për palët e interesit.

Referencat dhe citimet duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association). Në referenca bibliografike futen vetëm burimet që janë cituar diku në tekst dhe jo materialet që janë shfrytëzuar për lexim të përgjithshëm. Ja disa shembuj të huazuar nga botimi i 6<sup>te</sup> i APA-s për format e citimit.

## LITERATURA/REFERENCAT

(mbiemri dhe emri i autorit, viti i botimit, titulli i librit, vendi i botimit dhe botuesi):

Një autor

Alexie, S. (1992). *The business of fancydancing: Stories and poems*. Brooklyn, NY: Hang Loose Press.

Autorësi e përbashkët dhe i publikuar nga një botues

- Association. (1994). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (4th ed.). Washington, DC: Author.
- Autor anonim
- Dorland's illustrated medical dictionary* (31st ed.). (2007). Philadelphia, PA: Saunders.
- Kapitull libri
- Booth-LaForce, C., & Kerns, K. A. (2009). Child-parent attachment relationships, peer relationships, and peer-group functioning. In K. H. Rubin, W. M. Bukoëski, & B. Laursen (Eds.), *Handbook of peer interactions, relationships, and groups* (pp. 490-507). New York, NY: Guilford Press.
- Document nga ERIC
- Shyyan, V., Thurloë, M., & Liu, K. (2005). *Student perceptions of instructional strategies: Voices of English language learners with disabilities*. Minneapolis, MN: National Center on Educational Outcomes, University of Minnesota. Retrieved from the ERIC database. (ED495903)
- Referenca për Revista Shkencore dhe gazeta në versionin e printuar
- Një autor
- Ëilliams, J. H. (2008). Employee engagement: Improving participation in safety. *Professional Safety*, 53(12), 40-45.
- Nga dy deri në shtatë autorë [rendit të gjithë autorët] / grup autorësh
- Keller, T. E., Cusick, G. R., & Courtney, M. E. (2007). Approaching the transition to adulthood: Distinctive profiles of adolescents aging out of the child welfare system. *Social Services Review*, 81, 453-484.
- Tetë apo më shumë autorë [rendit gjashtë autorët e parë, ... dhe autorin e fundit] / grup autorësh
- Wolchik, S. A., West, S. G., Sandler, I. N., Tein, J.-Y., Coatsworth, D., Lengua, L., ... Griffin, W. A. (2000). An experimental evaluation of theory-based mother and mother-child programs for children of divorce. *Journal of Consulting and Clinical Psychology*, 68, 843-856.
- Revistë javore
- Mathews, J., Berrett, D., & Brillman, D. (2005, May 16). Other winning equations. *Newsweek*, 145(20), 58-59.
- Artikull i gazetarisë pa autorë dhe renditje të çrregullt
- Generic Prozac debuts. (2001, August 3). *The Washington Post*, pp. E1, E4.
- Artikuj të marrë nga burime on-line
- Senior, B., & Swales, S. (2007). Inside management teams: Developing a teamwork survey instrument. *British Journal of Management*, 18, 138-153. doi:10.1111/j.1467-5512.2006.00507.x
- Artikull nga një revistë on-line
- Lodewijkx, H. F. M. (2001, May 23). Individual-group continuity in cooperation and competition under varying communication conditions. *Current Issues in Social Psychology*, 6(12), 166-182. Nxjerrë nga <http://www.uiowa.edu/~grpproc/crisp/crisp.6.12.htm> dhe data se kur është marrë (26.07.2015)
- Raporte on-line nga organizata joqeveritare
- Kenney, G. M., Cook, A., & Pelletier, J. (2009). *Prospects for reducing uninsured rates among children: How much can premium assistance programs help?* Retrieved from Urban Institute website: <http://www.urban.org/url.cfm?ID=411823>